



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR TË DREJTËN E INFORMIMIT DHE MBROJTJEN E TË
DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E PËRGJITHSHME PËR MBROJTJEN E TË DHËNAVE PERSONALE
DREJTORIA E ANKESAVE DHE HARMONIZIMIT

Nr. 1495/1 prot.

Tiranë, më 02.06.2025

Lënda: Dhënie mendimi lidhur me projektvendimin *“Për ngritjen, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Ekipit të Përgjigjes ndaj Emergjencave dhe Krizës së Sigurisë Kibernetike”*

KRYEMINISTRISË

Tiranë

Zyra e Komisionerit për të Drejtën e Informimit dhe Mbrojtjen e të Dhënave Personale (në vijim *“Zyra e Komisionerit”*) ka administruar shkresën tuaj nr. 1338/1 prot., datë 28.05.2025, protokolluar me tonën me nr. 1495 prot., datë 30.05.2025, me anë të së cilës dërgoni për mendim projektvendimin *“Për ngritjen, mënyrën e organizimit dhe funksionimit të Ekipit të Përgjigjes ndaj Emergjencave dhe Krizës së Sigurisë Kibernetike”* (në vijim *“projektvendimi”*), si dhe relacionin shoqërues.

Nga shqyrtimi i materialit të vendosur në dispozicion, vërejmë se projektvendimi ka në fokus, krijimin e një grupi ndërinstitucional të përbashkët me profil teknik, me qëllim hartimin e planit të masave, menaxhimin dhe trajtimin e emergjencave dhe krizave të sigurisë kibernetike në Republikën e Shqipërisë.

Për sa më sipër, Zyra e Komisionerit vlerëson se, projektvendimi është në përputhje me legjislacionin për mbrojtjen e të dhënave personale, e për këtë arsye shprehet dakord me miratimin e tij.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

KOMISIONERI

Besnik Dervishi